



01/Nr. 7326/2019  
Data: 09.08.2019

## PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e shtatë -VII- për vitin 2019 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 02.07.2019 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Medina Imishti (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Përfaqësuesi i OSB-së. Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Themelimi i grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2020.
3. Informatë mbi raportin e auditorit të përgjithshëm për komunën për vitin 2018.
4. Plani i veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2018.
5. Shqyrtimi i propozimit për miratimin e planit të veprimit për transparencë 2019-2023.
6. Njoftim për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2019.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

### MIRATOHET RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

### MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Themelimi i grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin. Ju e dini se edhe vitin e kaluar ky grup punues është përbërë nga Komiteti për Politikë dhe Financa kështu që ne prapë mundemi me përcjell për kuvend ta formojmë grupin punues.

**Nuriman Kuka** thekson:- a ka mundësi në këtë komision shembull te hiqem unë e të vjen dikush nga jashtë apo nga struktura komunale që ka vizion më tepër dhe që mendon më shumë, për shkak se është mirë të kombinohe mi pak e jo të lihen të gjitha punët në Komitetin për Politikë dhe Financa.

**Kryesuesi** thekson:- ky është plani i punës së kuvendit ne e bëjmë planin për vete. Mundesh ti me u tërheq e me të zëvendësuar ty prej partisë tënde. Është plan i kuvendit i shqyrtojmë pikat gjatë takimit që do ta kemi si komision së bashku me ekzekutivin e komunës.

**Kryesuesi** thekson:- do të thotë mbet si propozim që anëtarët e KPF –së të jenë në komision. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA THEMELIMI I GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### **3. Informatë mbi raportin e auditorit të përgjithshëm për komunën për vitin 2018.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** thekson:- Zyra e Auditimit e ka bërë publikimin e këtij raporti njashtu edhe ne e kemi publikuar ne faqe të komunës. Sa i përket këtij raporti opinioni është i pamodifikuar me theksim të çështjes njëjtë si vitin e kaluar. Janë dhënë rekomandimet nga zyra e auditorit, për vitin 2018 kemi 7 rekomandime krahasuar me 2017 që kemi pasur 8 rekomandime që do të thotë një e kemi plotësuar, ndërsa prej 7 që janë 3 rekomandime janë në proces të zbatimit e 4 janë të pazbatuara. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- te çështja e raportit të auditimit e dini edhe vitin e kaluar kemi shprehur shqetësimet tona dhe mangësitë që iu kanë përcjellur në moszbatimin e përgjegjësi ve që i keni brenda komunës si rekomandime të auditorit të jashtëm. Një nga rekomandimet që nuk po zbatohet dhe nuk po gjen zbatim është çështja e auditorit të brendshëm sepse nuk ka qenë çështje që nuk mund të kryhet deri tash po të ishte marr seriozisht. Çështja e parë pse ka kaluar kaq kohë e gjatë e të mos ketë një auditorë të brendshëm që kish lehtësuar punën edhe juve edhe për qytetarët do të ishte transparencë më e madhe edhe për ne si opozitë dhe për auditorin e jashtëm do të ishte më e mirë, e dyta vitin e kaluar e kemi pasur si çështje se kush merret me rekomandimet, kush i vlerëson rekomandimet, sa janë zbatuar sa nuk janë zbatuar, kush e merr përgjegjësinë në komunë dhe ka qenë nëse të kujtohet z.Shabi përgjegjësinë se ka pasur asnjë ia kemi lënë gjithmonë Drejtorit për Buxhet e Financa për arsye që nuk i di. Pse nuk e keni bërë edhe këtë zgjidhje se edhe kjo mund të jetë një pikë e veçantë se nuk keni një përgjegjës me u marr me rekomandimet sa zbatohen sa nuk zbatohen por ia keni lënë Drejtorit për Buxhet e Financa? Përndryshe nuk shoh që ka ndonjë progresivitet në zbatimin e rekomandimeve nga vitet e kaluara te auditorit të jashtëm nga hendikepi që nuk ka auditorë të brendshëm të komunës që nuk e keni marr seriozisht si komunë që i bie drejtpërdrejt kryetarit që është një gabim shumë i madh.

**Kryesuesi** thekson:- u potencua se kryetari duhet të sigurojë përmbushjen e kërkesës respektivisht duhet të rekrutojë auditorë të brendshëm dhe thuhet në mungesë të tij ka mundësi Ministria e Financave. Vitin e kaluar kush e ka bërë? Në mungesë të Ministrisë së Financave a ka mundësi me u zëvendësuar dikush tjetër?

**Shabi Rexhallari** thekson:- Ministria e Financave, Departamenti i Auditimit. Vitin e kaluar kemi bërë kërkesë por nuk kanë ardhur për rrethana të vetat të pasqaruara për shkak se kanë pasur edhe disa komuna të tjera e nuk kanë mundur me arrit. Në këtë vit përsëri kemi bërë kërkesë por ende përgjigje nuk kemi marr nga ata, kanë një staf të vogël dhe në momentin që kanë mundësi vijnë nëse nuk kanë mundësi nuk vijnë për shkak që edhe ata kanë ministri që duhet me i audituar. Zyra Kombëtare e Auditimit vjet ka shpallur tender për me ia audituar disa komuna dhe ka qenë një ekip e auditimit privat që i ka audituar 5 apo 6 komuna për shkak se edhe ata vet nuk kanë pasur mundësi me i audituar.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- auditorë privat ka dhe tash janë kompanitë e di që këtë vit edhe ligji e lejon me shpall tender e jo me ardhur shembull qeveria me ta imponuar por kush e merr tenderin por mua më intereson auditori i brendshëm pse nuk po gjen zbatim me u emëruar ose me u përzgjedh me pas komuna një auditorë të brendshëm, bëhet fjalë për një vend pune nuk është tragjike tash me shpall vend pune për auditorë sepse auditori i brendshëm është në interes të komunës se ia lehtëson punët komunës na e lehtëson punën të gjithë neve dhe auditorit të jashtëm përndryshe a vjen a nuk vjen auditori i jashtëm nëse ka kohë nuk besoj që është ndonjë farë transparence për komunën sepse nuk ka seriozitet nëse thuhet ashtu ne bëjmë kërkesë e ato nëse mundem vij e nëse nuk mundem nuk vij kjo nuk është e pranueshme prandaj auditori i brendshëm është dashur me u harruar kjo punë por në përgjithësi nuk shoh seriozitet për me zgjidh këtë punë.

**Nuriman Kuka** thekson:- me ta thënë të drejtën çka pata me thënë e tha z.Mehmeti por unë kisha thënë duhet me u përpjekë shumë për këtë punë se gjithmonë ka ndryshime në këtë çështje por jam i mendimit me çdo kusht ne ta kemi një auditorë të brendshëm tash ekzekutivi a e merr special vetëm për atë punë apo edhe për punë të tjera veç më së miri kishte me qenë edhe me shpall konkursin apo me pranuar një person adekuat për këtë çështje në mënyrë që mos ta diskutojmë këtë çështje.

**Mallzum Qajani** thekson:- sa i përket auditorit të brendshëm komuna e Hanit të Elezit ka një problem për numrin e të punësuarve për shkak se kemi mungesë të punëtorëve në të gjitha sektorët , por megjithatë rritja e stafit është segment i mbyllur dhe pa lejimin nga Ministria e Financave nuk mund ta shtojmë stafin. Raporti i auditimit nuk ka gjetur të shkelura ligjore po ka gjetur moszbatim të procedurave deri në fund dhe në vitin e kaluar kemi bërë një raport për me i tejkualuar. Përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve të auditorit është secila drejtori dhe zyra e kryetarit të komunës.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- aq të parëndësishëm siç po e bënë nënkryetari auditorin nuk besoj që shkon në interesin e qytetarëve dhe vetë komunës për shkak se auditori ka përgjegjësi ligjore ashtu siç keni përgjegjësi ligjore edhe ju vetë këtu në komunë si ekzekutiv i komunës dhe nëse është përgjegjësi e çdo drejtorie me i zbatuar rekomandimet e auditorit kush jep përgjegjësi këtu. Sipas nënkryetarit këto rekomandime kanë me u përcjell çdo vit dhe nuk ka lidhje se a zbatohen apo nuk zbatohen por është një rutinë që ka me shkuar dhe nuk ka ndonjë problem, mirëpo ka problem këtu sepse ka shkelje ligjore dhe është e domosdoshme me pas auditorë. Nuk është mirë që të potencohet që nuk kemi staf por unë mendoj që keni mjaftë persona që shëtiten nëpër komunë dhe së paku jepjani përgjegjësinë një auditori të brendshëm dhe fundi fundit të jetë një konkurs i brendshëm për këtë çështje.

**Mallzum Qajani** thekson:- komuna ka problem me staf dhe në raport të auditorit nuk ka shkelje ligjore por ka moszbatim deri në fund të procedurave që është dashur me u kryer dhe shkelje ligjore nuk ka. Kemi shumë drejtori që një person i kryen dy apo tri detyra të punës dhe ka punëtorë që janë më pak të angazhuar dhe ka që më shumë janë të angazhuar por komuna ka nevojë për staf dhe i cili staf nuk i lejohet nga Ministria e Financave.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- ju potenconi që nuk ka shkelje ligjore por në disa seanca të kuvendit është bërë kërkesë për keqpërdorim të buxhetit për një vizitë që e keni pasur në Shqipëri , këtë e potencova si shembull që me të tregu që ka shkelje ligjore. Për ato shkelje ligjore po të ishte auditori i brendshëm së paku kish rekomanduar që mos me u përsëritur tjetër herë është shkelje ligjore është keqpërdorim i buxhetit, është një cent apo një milion nuk ka lidhje por ka shkelje ligjore. Auditori i brendshëm nëse është efikas, transparent është serioz atëherë i evidenton edhe këto shkelje qoftë edhe një shkelje ligjore kush ka audituar brenda komunës për çështje të transparencës, të buxhetit, menaxhimi i buxhetit, i projekteve, kush ka menaxhuar kush ka vlerësuar në projektet që janë kryer nga komuna se sa janë efikas. A nuk është shkelje ligjore kur një projekt nuk kryhet si duhet? A nuk është shkelje ligjore që çdo projekt që kryhet duhet të riparohet çdo vit? Edhe këto janë shkelje ligjore joefikasiteti i komunës, joserioziteti i komunës për atë e ka rëndësinë e vet, duhet gjetur staf është e domosdoshme e dini rëndësinë e kësaj por megjithatë të bëhemi më serioz e ta zgjidhim se këtu po të jep rekomandime të pazbatuara jo të zbatuara thotë këtu janë në proces të zbatimit por janë të pazbatuara të përcjella vit pas viti.

**Teuta Shkreta** thekson:- kordinimi i pushtetit lokal me atë qendror bie ndesh me këtë që thatë rritja e stafit. Pse këta i rritin vazhdimisht përgjegjësitë ndaj një punëtori por në staf nuk e bëjnë rritjen e numrit?

**Mehmet Ballazhi** thekson:- nuk është problemi që janë rritur përgjegjësitë e nuk kemi staf mirëpo përgjegjësitë janë rritur dhe staf ke pasur. Po që se marrim hapësirën kohore para tri viteve deri tash sa persona janë punësuar në komunë dhe brenda këtij numri të caktuar kanë pasur hapësirë me gjet një auditorë të brendshëm. Kjo kërkesë nuk është që tri vite por është që shumë vite dhe jo që janë rritur përgjegjësitë por nuk ka pasur seriozitet me punësuar një auditorë . Auditori ka përgjegjësi ligjore dhe është shumë i rëndësishëm dhe këtë ju e dini si ekzekutiv por nuk e keni parë shumë të rëndësishëm.

**Shabi Rexhallari** thekson:- komunat tjera kanë auditorë por kanë edhe rekomandime dhe nuk mundet me i hequr rekomandimet për shkak se janë disa rekomandime që nuk mund të hiqen me përpikëmeri.

**Teuta Shkreta** thekson:-te kordinimi me pushtetin lokal si komunë a duhet të dërgojmë ndonjë listë të mbingarkesës në punë apo duhet të jetë buxheti më i shtuar për me rrit stafin?

**Mallzum Qajani** thekson:- me qarkore buxhetore Qeveria e Kosovës precizon shpenzimet për vitin e ardhshëm dhe dimë që në vitin e ardhshëm sa punëtorë kemi me i pasur dhe në cilin sektorë. Komuna për çdo vit bënë kërkesë për shtimin e numrit të stafit por qeveria vendosë.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA INFORMATA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM PËR KOMUNËN PËR VITIN 2018 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### **4. Plani i veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2018.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA PLANI I VEPRIMIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË RAPORTIT TË AUDITIMIT 2018 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### **5. Shqyrtimi i propozimit për miratimin e planit të veprimit për transparencë 2019-2023.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Edon Curri** thekson:- plani është propozuar për shkak se na obligon udhëzimi administrativ që është në komuna dhe rregullorja për transparencë. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË 2019-2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**6. Njoftim për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2019.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- Këshilli për Siguri në Bashkësi mbanë mbledhje të rregullta mujore dhe diskutohen çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë. Gjatë këtij gjashtë mujori organet e sigurisë kanë raportuar për sigurinë në territorin e komunës. Kemi pasur një rast në qershor kur një fëmijë është sulmuar nga ujku dhe si komunë kemi kërkuar prej shoqatës që me marr masa për me i asgjësuar.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- kur kemi diskutuar për trajtimin e qenëve endacak kemi potencuar që e dimë që ligji nuk e lejon me vepruar por me gjithë atë do të ishte mirë me i planifikuar rreziqet siç ishte rasti i ujkut për shkak se e njëjta mund të ndodhë me qentë endacak. Planifikimet për preventiva do të ishte mirë me i diskutuar më seriozisht me organet tjera relevante që janë në Këshillin Komunal në Bashkësi.

**U VOTUA NJOFTIMI PËR AKTIVITETET E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR GJASHTË MUJORIN E VITIT 2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**7. Të ndryshme.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nuriman Kuka** thekson:- çështja e ujit në Han të Elezit si është? Si është gjendja e arsimit nëpër shkolla?


**Refet Kalisi** thekson:- në Han të Elezit probleme nuk kemi për momentin por në “Lagje të Re”.

**Menduh Vlashi** thekson:- mësimi ka përfunduar dhe nuk kemi pasur ndonjë problem të theksuar.

Mbledhja përfundoi në ora 11:45

**Procesmbajtësi**

**Ayni Bushi**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**MSc. Qamush Brava**

